



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Gjeçira - Vlada - Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRATVO ZDRAVSTVA
MINISTRY OF HEALTH



Integrated
Health
Services

Shërbimet Shëndetësore të Integruara
Integrirane Zdravstvena Usluga

SDC project implemented by Swiss TPH

PROJEKTI SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË INTEGRUARA

Shërbimet Shëndetësore të Integruara (IHS), si nisma më e re mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, punon me institucionet e Kosovës për të facilituar edhe më tej mbështetjen për kapacitetet vendore në sektorin e shëndetësisë nëpërmjet një procesi gjithpërfshirës në përputhje me politikat shëndetësore vendore. Projekti IHS fokusohet tek Sëmundjet Jo-Ngjitëse (SjN), që përbëjnë një problem mbarëbotëror, duke qënë se SjN janë 7 nga 10 shkaqet më të shpeshta të vdekjeve. Në Kosovë, një në 7 persona mbi moshën 40 vjeçare preket së paku nga diabeti, hipertensioni dhe/ose sëmundjet kronike të mushkërive. Fragmentimi aktual i shërbimeve shëndetësore për SjN-të përkeqëson drejtpërsëdrejti cilësinë e kujdesit për popullsinë e prekur prej tyre dhe shkallën e komplikimeve të ndërlydhura me to.

Nëpërmjet rolit të vet facilitues, projekti IHS fuqizon koordinimin ndërmjet nivelit të Mjekësisë Familjare dhe Spitaleve të Përgjithshme, duke mundësuar përdorimin efektiv të protokolleve klinike dhe duke siguruar rezultate të qëndrueshme për proceset zhvillimore të partnerëve. Përpjekjet e përbashkëta me projektin tjetër të mbështetur nga Zvicra (Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor), mandati i të cilit është të sigurojë shërbime cilësore në nivel të mjekësisë familjare për nevojat shëndetësore të bartësve të SjN-ve, i shërben këtij qëllimi po ashtu. Politikëbërësit dhe planifikuesit janë përfshirë në çdo hap. Kjo qasje fuqizon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të pacientëve, kujdestarëve dhe qytetarëve.

Projekti IHS trajton posaçërisht grupet e cënueshme që përgjithësisht kanë status shëndetësor më të dobët, përballen me situata më të vështira ekonomike, janë në rrezik më të shtuar të përjashtimit social dhe kanë njohuri më të pakta shëndetësore në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Aktivitetet e projektit IHS janë në përputhje me nevojat gjinore dhe lehtësojnë gjithpërfshirjen sociale për popullsinë e synuar.

www.ihsproject.org



<https://www.facebook.com/IHSProjectKs>



<https://www.linkedin.com/company/integrated-health-services-project-kosovo>

Qëllimi i projektit IHS:

Institucionet shëndetësore në secilin nivel në vend janë fuqizuar për të ofruar shërbime shëndetësore cilësore dhe kosto-efektive, duke përbushur nevojat shëndetësore të pacientëve të prekur nga SJN-të, ndërkohë që fuqizojnë komunitetet e pacientëve për rolin e tyre në menaxhimin e shëndetit të tyre.

Rezultatet e pritshme të projektit IHS:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore nga Spitalet e Përgjithshme në Gjakovë dhe Pejë përmes disa mekanizmave që përfshijnë: zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve shëndetësorë, zbatimin e protokolleve klinike dhe linjave të kujdesit dhe rritjen e disponueshmërisë dhe qasjes së shërbimeve për grupet e cenushme.
- Vazhdimësia e kujdesit ndërmjet nivelit të Mjekësisë Familjare dhe Spitaleve të Përgjithshme që mundësohet përmes: krijimit të sistemit funksional të referimit dhe referimit-kthyes dhe fuqizimit të rolit të infermierëve si mekanizëm që zbut mungesën e theksuar të punëtorëve shëndetësorë në vend.
- Kornizat e politikave në nivel vendi nxisin kujdesin e integruar me fokus tek individit dhe shërbejnë për të replikuar përvoja pozitive në struktura të tjera shëndetësore në Kosovë.

Të dhënat kryesore për projektin IHS:

Kohëzgjatja e Fazës I të projektit Shërbimet Shëndetësore të Integruara është katër vjet (nëntor 2022 - tetor 2026).

Financimi nga Qeveria e Zvicrës për projektin IHS është CHF 5,550,000. Aktivitetet zbatohen nga institucionet vendore dhe rajonale, me përkrahjen e Swiss Tropical and Public Health Institute.

Spitalet e Përgjithshme në Gjakovë dhe Pejë janë dy partnerët kryesorë të projektit që angazhohen në aktivitete specifike bashkë me disa nga Qendrat e Mjekësisë Familjare që ushtrojnë aktivitetin në disa nga komunat e këtyre dy rajoneve.

Implementuar nga:

Swiss TPH



Swiss Tropical and Public Health Institute